



Pa. nr. 08-13

Komisioni për Mbrojtjen e konkurrencës në bazë të nenin 28 dhe nenin 19 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10 dhe 136/11 dhe 41/14 dhe 53/16), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Erste Kard Klub shpk, me seli në rr. Prashka nr. 5, 10000 Zagreb, Kroaci nëpërmjet Shoqërisë së Avokatëve Georgievski nga Shkupi, në seancën e mbajtur me datë 08.02.2017, miratoi

AKTVENDIM

Vërtetohet përqendrimi me të cilin Erste Kard Klub shpk, me seli në rr. Prashka nr. 5, 10000 Zagreb, Kroaci fiton kontrollin e plotë ndaj Shoqërisë Financiare për dhënien dhe administrimin e kartelave të kreditit Diners Klub Internacional MAK SHPKNJ P Shkup, me seli në rr. GTC nr. 2-2, 1000 Shkup, nëpërmjet blerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrimin të paguaj taksë administrative të njoftimit për përqendrim në shumë prej 6 000,00 den. dhe për vendimin në shumën prej 30.000,00 den, sipas numrit të tarifës 28-a të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, në datë 29.12.2016, plotësuar më 30.01.2017, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) merr njoftimin për përqendrim me të cilin Erste Kard Klub shpk, me seli në rr. Prashka nr. 5, 10000 Zagreb, Kroaci fiton kontrollin e plotë ndaj Shoqërisë Financiare për dhënien dhe administrimin e kartelave të



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



kreditit Diners Klub Internacional MAK SHPKNJP Shkup, nëpërmjet blerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit të përqendrimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të dhënave të parashtruara në Njoftimin e përqendrimit dhe anekseve të tij konstatoi si më poshtë:

Erste Kard Klub shpk, kryen veprimtarinë e ndërmjetësimit dhe të shërbimeve financiare dhe është anëtare e Grupit të Bankave Erste në Kroaci, e cila është pronare i vetme e Erste Kard Klub. Në bazë të marrëveshjes për franshizë me Diners Club International®, Erste Kard Klub ka të drejtë të lidhë kontrata për pranimin dhe lëshimin e kartave Diners Club në Kroaci, si dhe të punojë në shtetet ku ka të drejtën e nën-franshizës. Gjithashtu, Erste Kard Klub është e vetmja shoqëri në tregun kroat që lidhë kontrata për pranimin e kartelave Discover®, e cila është në pronësi të Discover Financial Services.

Erste Kard Klub gjithashtu, jep dhe lidhë kontrata për pranimin e kartave Visa dhe Mastercard, pranimin e kartave JCB dhe pranimin e njëhershme dhe ciklike të kartave Maestro në Erste Bankë.

Në republikën e Maqedonisë në mënyrë indirekte është e pranishme në këto shoqëri:

- Shparkase Banka ShA Shkup me seli në rr. Makedonija nr. 9-11, 1000 Shkup dhe
- C-AMC 1 SHPKNJP Shkup me seli në rr. 9-11, 1000 Shkup dhe fushëveprimi i saj blerjen dhe shitjen e pasurisë së patundshme të vetë.

Shoqëria për dhënien dhe administrimin e kartelave të kreditit Diners Klub Internacional MAK SHPKNJP Shkup është shoqëri financiare e cila merret kryesisht me veprimtarinë e dhënies dhe administrimit të kartelave të kreditit, në bazë të licencës për themelim dhe punë, dhënë nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Financiare. Diners Klub Internacional MAK SHPKNJP Shkup jep dhe administron kartelat e kreditit me logon e Diners Club®, në bazë të marrëveshjes së nën-franshizës të vitit 2004, të nënshkruar me Diners Club International SHBA dhe Diners Club Belgrade Serbi. Në bazë të marrëveshjes së nën-franshizës, Diners Klub Internacional MAK SHPKNJP Shkup ka të drejtë të përdorë markën tregtare Diners Club®, në Maqedoni, gjegjësisht të jep kartela të kreditit me logon e Diners Club®, në Maqedoni.

Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, pasi ajo i plotëson kërkesat e nenit 12 (1), pika 2) dhe neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pika 6 (b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës miraton aktvendim në formë të shkurtuar, Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, është në përputhje me të sepse nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh vlerësimin e këtillë të përqendrimit, Komisioni vendosi ashtu siç parasheh dispozitivi i këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Mjeti juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për nisje të kontestit administrativ në Gjyqin administrativ në Republikën e Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
BLLAGOJ ÇURLINOV